



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 24 datë 17.10.2025

P Ë R

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “SHTËPIZA E MADHE”,
STRUKTURË BANIMI DHE SHËRBIMI ME 3, 12 DHE 19 KATE MBI TOKË DHE 3
KATE NËNTOKË, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË TIRANË

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” i ndryshuar, me propozim të subjekteve zhvilluese shoqërive “Adi-M” sh.p.k. dhe “Eneriko” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

V E N D O S I:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Shtëpiza e Madhe”, Strukturë banimi dhe shërbimi me 3, 12 dhe 19 kate mbi tokë dhe 3 kate nëntokë, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë, me subjekt zhvillues shoqëritë “Adi-M” sh.p.k. dhe “Eneriko” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet kërkuarit vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Enea Karakaci



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Adelajda Roka



Nënshkruar më datë 18/03 2026